

## Depozitë me afat 5 vjeçar me normë fikse interesi (5Y term deposit with fixed interest rates)

### Informacion rreth Bankës

#### Intesa Sanpaolo Bank Albania

Drejtoria Qendrore: Rr" Ismail Qemali, Nr. 27,  
Kutia postare 8319  
1001 Tirane, Shqipëri  
Tel: +355 4 22 76 000; Fax +355 4 22 48 762  
Website: www.intesasanpaolobank.al

### Karakteristikat dhe rreziqet e Depozitës me afat 5 vjeçar me normë fikse interesi

#### Karakteristikat e Depozitës me afat 5 vjeçar me normë fikse interesi

Depozita me afat 5 vjeçar me normë fikse interesi është një depozitë bankare me interes fiks, i cili likuidohet çdo vit në llogarinë rrjedhëse. Kjo depozitë mund të hapet vetëm në monedhën LEK, EUR dhe USD. Në datën e maturimit, depozita mund të rinovohet me normën e interesit të publikuar në Kushtet e Punës së Bankës në momentin e rinovimit. Rinovimi mund të jetë vetëm Principali, kurse interesi (minus tatimin në burim) kreditohet çdo vit në llogarinë rrjedhëse të klientit.

Klienti duhet të ketë një llogari rrjedhëse, të lidhur me depozitën.

#### Tregu i synuar

Tregu i synuar për këtë depozitë janë të gjithë klientët individë që duan të kryejnë investim afatgjatë dhe përfitimi nga investimi është normë fikse interesi me likujdim vjetor në llogarinë rrjedhëse.

#### Dokumentet e nevojshme

Pasaportë / Kartë Identiteti  
Kontrata e Depozitës

#### Shërbime Suplementare

Për hapjen e depozitës është e nevojshme një llogari rrjedhëse në të njejtën monedhë në të cilën do të çelet depozita.

#### Rreziqet e Depozitës me afat 5 vjeçar me normë fikse interesi

- 1.** Kompensimi i depozitave bazohet në nenin 33, paragrafi 1, pika a) e Ligjit nr. 53/2014, datë 22/05/2014 "Për sigurimin e depozitave", në bazë të të cilit ASD siguron dhe kompenson depozitat e çdo depozituesi në Bankë ose në degën e bankës së huaj deri në masën 100%, por në çdo rast jo më shumë se Lek 2,500,000 (dy milion e pesëqind mijë), pavarësisht nga numri i depozitave dhe monedha e tyre, që janë depozituar në Bankë.
- 2.** Llogaria rrjedhëse që lidhet me depozitën me afat është pa komision vetëm nëse përdoret ekskluzivisht për transaksionet e depozitës me afat dhe nuk lidhet me ndonjë produkt tjetër, në të kundërt do të aplikohet komisioni i mirëmbajtjes mujore sipas Kushteve të Punës në fuqi.
- 3.** Në rastin e depozitës në një monedhë të ndryshme nga monedha e të ardhurave, ekziston rreziku që lidhet me luhatjen e normave të interesit.

## Kushtet kryesore ekonomike

Lista e të gjitha kostove dhe shpenzimeve të produktit:

Monedha	Normë interesi
LEK	3.40%
EUR	2.00%
USD	2.50%

### Tatim i mbajtur në burim

Tatimi në burim aplikohet sipas ligjit shqiptar i pagueshëm në momentin e përfitimit të interesit 15% e interes të përfutur

### Komision rinovimi i Depozitës me Afat

Komision rinovimi për depozitën në LEK	50 LEK
Komision rinovimi për depozitën në EUR	0.30 EUR
Komision rinovimi për depozitën në USD	0.30 USD
Komision rinovimi për depozitën në GBP	0.30 GBP

### Komision Mirëmbajtje

Komision i mirëmbajtjes së llogarisë\* Falas  
LEK/ EUR/ USD/ GBP

\*Për referencë në pikës 2 në seksionin e "Rreziqet e Depozitës me Afat".

### Kosto të tjera të lidhura me depozitën

Lëvizjet e aktivitetit të Depozitës Falas

\* Klienti gëzon të drejtën që 1 herë në vit të marrë falas printimin e levizjes së llogarisë/ve.

Rritja e shumës së depozitës Falas  
(e aplikueshme vetëm në datën e maturimit)

Ulja e shumës së depozitës Falas  
(e aplikueshme vetëm në datën e maturimit)

Lëshimi i konfirmimit bankar 1,000 LEK  
(opsionale, sipas kërkesës së klientit)

### Shembull ilustrativ likujdimi i interesit

*Depozitë 5 Y me normë fikse interesi në LEK*

Shuma	100,000 LEK
Normë interesi	3.40%
Interesi bruto	3,400 LEK
Taksa	510 LEK
Interesi neto	2,890 LEK

*Depozitë 5 Y me normë fikse interesi në EUR*

Shuma	100,000 EUR
Normë interesi	2.00%
Interesi bruto	2,000 EUR
Taksa	300 EUR
Interesi neto	1,700 EUR

*Depozitë 5 Y me normë fikse interesi në USD*

Shuma	100,000 USD
Normë interesi	2.05%
Interesi bruto	2,050 USD
Taksa	307.50 USD
Interesi neto	1,742.50 USD

## Tërheqja para afatit, ndryshimi i njëanshëm i kushteve kontraktore dhe ankesat

Tërheqja e pjesshme	Nuk lejohet
Likuidimi i parakohshëm	Lejohet (Shuma e plotë)

Në rast të thyerjes së depozitës në vitin e parë, klienti nuk përfiton asnjë interes. Penaliteti është 100%.  
Në rast të thyerjes së depozitës në vitin e dytë, klienti do të përfitojë vetëm 30% të totalit të interesit (Interesi total do të llogaritet si shumë e interesit të likuiduar në vitin e parë dhe të interesit të përlllogaritur në vitin e dytë). Norma e penalitetit është 70%.

Në rast të thyerjes së depozitës në vitin e tretë, klienti do të përfitojë vetëm 40% të totalit të interesit (Interesi total do të llogaritet si shumë e interesit të likuiduar në vitin e parë, në vitin e dytë, si dhe të interesit të përlllogaritur në vitin e tretë). Norma e penalitetit është 60%.

Në rast të thyerjes së depozitës në vitin e katërt, klienti do të përfitojë vetëm 50% të totalit të interesit (Interesi total do të llogaritet si shumë e interesit të likuiduar në vitin e parë, në vitin e dytë, në vitin e tretë, si dhe të interesit të përlllogaritur në vitin e katërt). Norma e penalitetit është 50%.

Në rast të thyerjes së depozitës në vitin e pestë, klienti do të përfitojë vetëm 60% të totalit të interesit (Interesi total do të llogaritet si shumë e interesit të likuiduar në vitin e parë, në vitin e dytë, në vitin e tretë, në vitin e katërt si dhe të interesit të përlllogaritur në vitin e pestë). Norma e penalitetit është 40%.

### Ndryshimi i njëanshëm i kushteve kontraktore

Çdo ndryshim i kushteve, i cili përcaktohet në mënyrë të shprehur në kontratën e depozitës, do të jetë efektiv pas dakordësisë me shkrim të palëve. Asnjë ndryshim i kushteve të përcaktuara shprehimisht në kontratën e depozitës nuk do të jetë efektiv nëse nuk janë dakordësuar me shkrim midis palëve.

### Ankesat

Ankesat do të paraqiten në bankë duke përdorur një nga format e mëposhtme:

- Në formë shkresore përmes postës zyrtare të bankës;
- Në "Kutinë e ankesave & sugjerimeve" që ndodhet në degë (Ju dëgjojmë 100%);
- Ankesa me shkrim të cilat dërgohen nëpërmjet faqes të internetit të bankës në adresën zyrtare të email-it: [complain@intesasanpaolobank.al](mailto:complain@intesasanpaolobank.al)
- Në Qendrën e Kontaktit: 08006000

Koha e kthimit të përgjigjes nga ana e Bankës është maksimumi brenda 30 ditë nga data e marrjes së ankesës.

### Fjalorthi i Termave Kryesore

**ASD**- Agjencia e Sigurimit të Depozitave (Agjencia) është person juridik publik, me seli në Tiranë, e cila ushtron funksionet e saj, me qëllim përmbushjen e objektivave në zbatim të Ligjit Nr. 53/2014, datë 22.05.2014, "Për Sigurimin e Depozitave".

**Interesi Neto**- vlera bruto e interesit minus tatimin në burim.

**Tatimi në burim** është një kërkesë e qeverisë për pagesin për një të ardhur të tatueshme në burim ose tatimin e zbritshëm nga pagesa në favor të qeverisë Ky tatim aplikohet më së shumti në të ardhurat nga puna, pagesa interesash ose dividendë.

**Penalitet**- Vlera e interesit e gjeneruar por jo e përfituar prej klientit.